

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“TOTTO” sh.p.k**

Sot ne daten 15.05.2024 bazuar ne ligjin nr 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare” ortaku:

Fation Kuqari i datelindjes 10.05.1994, lindur ne Fier, e banues ne Tirane, me nr personal J40510086V, vendosi te themeloje shoqerine

“TOTTO” sh.p.k

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar quhet **“TOTTO” sh.p.k** dhe e ka seline ne adresen Liqeni i Thatë , Rruga Peti, Kompleksi “Ferari”, Kati i 3.

NENI 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Tregti me shumice dhe pakice te mallrave ushqimore dhe industriale si dhe te gjitha veprimtaritë dhe shërbimet që ligji u lejon shoqërive tregtare pa asnjë kufizim.

NENI 3


Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike dhe financiare te shoqerise me pergjegjes te kufizuar **“TOTTO” sh.p.k** do te jete pa afat.

NENI 4

Kapitali themelues i shoqerise 100 000 (njeqind mijë), i shprehur ne 1 kuote me vlore 100,000 leke, i kontribuar nga ortaku:

Fation Kuqari 1 kuote me vlore 100,000 Leke.

Ky kapital mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit qe do te marri ortaku.



NENI 5

Administrator e shoqerise me perjegjesi te kufizuar "TOTTO" sh.p.k, do te jetë Kleona Kuqari e datelindjes 10.07.2001, lindur ne Fier, e banues ne Tirane, me nr personal K15710069W, per nje periudhe 5 vjecare..

NENI 6

Administratori i shoqerise se lartpermendur, eshte i veshur me te gjitha atributet per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, pa asnje perjashtim dhe kufizim. Ai ka mundesi te perpiloje te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arrijen e qellimeve te shoqerise. Ai ka te drejte te bleje dhe te kembeje pasuri, te lidhet me shoqeri te tjera. Ai kryen cdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave shteterore dhe private qe kane te bejne me garancite dhe veprimet hipotekore.

Te gjitha keto atributet do te shoqerohen rast pas rasti me autorizim te vecante nga ana e ortakeve te vetem dhe vetem ne kete menyre veprimet e administratorit marrin fuqi ligjore.

NENI 7

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti pervec urdhrove te vecanta qe jepen nga ortaku i vetem. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel i shoqerise me rezultatin ekonomik, fitim-humbje, bazuar ne ligjet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit nga shoqerite private te percaktuara nga organet kompetente te sistemit fiscal.

Bilanci kontabel miratohet nga ortaku i vetem te shoqerise. Me miratimin e bilancit kontabel vjetor, ortaku i vetem vendos per krijimin e fondeve te ndryshme per shoqerine si ate te akumulimit, te rezerves etj.

NENI 8

Administratori ka te drejte te hyje ne marredhenie ekonomiko-financiare me autorizim te ortakut te vetem, me persona fizike dhe juridik, vendas apo te huaj, mbi bazen e kontratave, bazuar ne legjislacionin Shqiptar.

NENI 9

Ne marredhenie financiare shoqeria vepron me monedhen vendase, Lekun. Ajo ka te drejte te perdore edhe valuten e huaj konform legjislacionit ne fuqi.

NENI 10

Marredheniet e shoqerise me personelin e saj do te rregullohen mbi bazen e legjisacionit te punes. Shoqeria ka te drejtë te pushoje cdo punonjes te personelit nga puna per shkak te indisiplinimit ose paaftesise profesionale duke kerkuar gjithashtu demshperblimin per demin e shkaktuar shoqerise nga punonjesit per faj te tyre.

NENI 11

Ne rast prishje te shoqerise, ortaket e vetem cakton nje likujdator i cili ne fund te likujdimi paraqet bilancin e likujdimit.

NENI 12

Ky akt themelimi hartohet ne kater kopje me vlore te barabarte secila.

ORTAKU I VETEM

FATION KUQARI

FATION KUQARI

Administratore

Zleono Kiqari

WA